



**PËRFUNDON FAZA E DYTË E PROJEKTIT
“STUDIMI I ATELIESË SË JANIT DHE VASILIT
NGA QESTORATI, NË KUADËR TË PIKTURËS
SË SHEK. XVIII-XIX”**

 **Kisha e Manastirit të Ipapandisë**

 **Kisha e Shën Gjergjit**

 **Kisha e Shën Mërisë**

Përfundoi faza e dytë e projektit të përbashkët "Studimi i Ateliesë së Janit dhe Vasilit nga Qestorati, në kuadër të pikturës së shek. XVIII-XIX" ndërmjet Institutit Kombëtar të Trashëgimise Kulturore dhe Institutit të Fizikës Bërthamore të Zbatuar. Ekspedita përmbyllëse u përqendrua në Sarandë, përkatësisht në kishat e Manastirit të Ipapandisë dhe Shën Gjergjit në Leshnicën e Sipërme si dhe kishën e Shën Mërisë në Kostar, ku u kryen matje me XRF - MRC Scientific Instruments 5000 (HANDHELD HARMFUL ELEMENTS ANALYZER), u verifikua programi ikonografik dhe gjendja e konservimit e pikturës murale. Puna do të vazhdojë në laboratorët respektivë ku do të studiohen dhe analizohen të dhënat e marra përfundimet e të cilave do të përfaqsojnë punën kërkimore - shkencore të IKTK dhe IFBZ në prezantimet e konferencat shkencore në kuadër të bashkëpunimit me IAEA (Agjensia Ndërkombëtare e Energjisë Atomike) Vjenë, Austri. Objektivi i përgjithshëm i projektit është promovimi dhe përmirësimi i aplikimit të teknikave bërthamore / atomike për ruajtjen dhe restaurimin korrekt të trashëgimisë kulturore në Shqipëri nëpërmjet një bashkëpunimi të fortë midis institucioneve shqiptare dhe organizatave ndërkombëtare.









